



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP. nr. 733/24

Data e vendimit :19.08.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Model Group" SH.P.K. kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mjete dhe vegla pune, material elektrik, sanitar dhe vegla tjera për mirëmbajtje të shkollave për nevojat e institucioneve shkollore dhe komunale dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Skenderajt" me numër të prokurimit 2024/643-24-7653-1-1-1/B05-0018767, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Skenderaj, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 19.08.2024, mori këtë:

VENDIM

I. Hedhet si palejuar, ankesa e OE "Model Group SH.P.K me nr. të protokollit 2024/0733, e datës 12.08.2024, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mjete dhe vegla pune, material elektrik, sanitar dhe vegla tjera për mirëmbajtje të shkollave për nevojat e institucioneve shkollore dhe komunale dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Skenderajt" me numër të prokurimit 2024/643-24-7653-1-1-1/B05-0018767, i iniciuar nga Komuna e Skenderaj, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Skenderaj që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e "Furnizim me mjete dhe vegla pune, material elektrik, sanitar dhe vegla tjera për mirëmbajtje të shkollave për nevojat e institucioneve shkollore dhe komunale dhe institucioneve tjera që

funksionojnë në kuadër të Komunës së Skenderajt” me numër të prokurimit 2024/643-24-7653-1-1-1/B05-0018767, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të

A r s y e t i m

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 12.08.2024, ka pranuar ankesën e OE ”Model Group” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me mjete dhe vegla pune, material elektrik, sanitar dhe vegla tjera për mirëmbajtje të shkollave për nevojat e institucioneve shkollore dhe komunale dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Skenderajt” me numër të prokurimit 2024/643-24-7653-1-1-1/B05-0018767 në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 29.07.2024, Komuna e Skenderaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ku afati i fundit për pjesëmarrje është me datën 12.08.2024.

Operatori Ekonomik ”Model Group” SH.P.K, me 12.08.2024, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 733/24 (Nr. protokolli) kundër njoftimit për kontratë të AK-së.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me mjete dhe vegla pune, material elektrik, sanitar dhe vegla tjera për mirëmbajtje të shkollave për nevojat e institucioneve shkollore dhe komunale dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Skenderajt” me numër të prokurimit 2024/643-24-7653-1-1-1/B05-0018767, me datën 29.07.2024 është publikuar në sistemin e-prokurimi njoftimi për kontratë, me datën 02.08.2024 është publikuar formulari standard për korrigjimin e gabimeve ndërkaq hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 12.08.2024.

Me datë 12.08.2024, OE ”Model Group” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokolli 733/2024.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, konstatohet se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të palejuar për faktin se sipas nenit 109 të LPP-së operatori ekonomik mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së vetëm pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim në Autoritet Kontraktues.

Sipas nenit 109 të LPP-së kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP-së, pas

udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu, edhe me nenin 64 par 1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohet se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të palejuar sepse nuk ka respektuar dispozitat ligjore të shtjelluara si më lartë, andaj i lejon autoritetit kontraktues – Komuna e Skenderaj, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me mjete dhe vegla pune, material elektrik, sanitar dhe vegla tjera për mirëmbajtje të shkollave për nevojat e institucioneve shkollore dhe komunale dhe institucioneve tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Skenderajt” me numër të prokurimit 2024/643-24-7653-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Ud. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit te vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Skenderaj

1x1 OE ankues

1x1 Arhivës së OSHP-së;

OSHP-së

Agim Sheqiri
Ud. Kryesuesi i Sekretariatit të

